



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 07.12.2022

Nr: 222

Ora: 11:00

V E N D I M

P Ë R

EDUKIMIN, INFORMIMIN DHE NDËRGJEGJËSIMIN E PAKICAVE KOMBËTARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË PËR ZGJEDHJET

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “g” dhe “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 4, të nenit 15, të ligjit nr. 79, datë 13.10.2017, “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Programi i edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve duhet të ketë pjesë përbërëse të tij edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve të pakicave kombëtare.
2. Programi i edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve të pakicave kombëtare do të zhvillohet në bashkëpunim dhe në konsultim edhe me organizatat joqeveritare të cilat përfaqësojnë interesat e pakicave kombëtare, si dhe me organizata apo institucione e përfaqësi ndërkombëtare kur është rasti.
3. Përcaktimi i gjuhëve të pakicave kombëtare në të cilat do të zhvillohet programi i edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi, si dhe në konsultim me ministrinë përgjegjëse për marrëdhëniet ndërkombëtare.
4. Programi përgatitet dhe zhvillohet për çdo edicion zgjedhor, si për zgjedhje të përgjithshme, ashtu edhe për zgjedhje të pjesshme apo për referendume.

Data: 07.12.2022 Nr: 222
Ora: 11:00



“Për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë për zgjedhjet”

5. Programi miratohet me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Struktura përgjegjëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për përgatitjen dhe zhvillimin e programeve të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve i paraqet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve draftin e programit për miratim.
6. Materialet edukuese, informuese dhe ndërgjegjësuese, të tilla por pa u kufizuar, si postera, fletëpalosje, titra/spote radiotelevizive, duhet të krijohen dhe/ose të përshtaten në gjuhën e pakicave kombëtare që jetojnë në vendin tonë.
7. KQZ organizon aktivitete të posaçme për zgjedhësit e pakicave kombëtare. Struktura përgjegjëse në KQZ për përgatitjen dhe zhvillimin e programeve të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve udhëheq punën për zhvillimin e këtyre aktiviteteve dhe sigurohet që ato të jenë publike dhe të hapura.
8. Struktura përgjegjëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për përgatitjen dhe zhvillimin e programeve të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve ka detyrimin t'i dërgojë paraprakisht, krahas të tjerëve, organizatave që përfaqësojnë zgjedhësit e pakicave kombëtare, të gjitha projektaktet të lidhura me organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve.
9. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve krijon të gjitha lehtësirat në marrjen në kohë të informacionit zgjedhor për zgjedhësit e pakicave kombëtare në gjuhën që ata flasin, përfshirë këtu për aq sa është e mundur edhe aktet e miratuara të KQZ.
10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
11. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI